



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
DREJTORIA E SIGURIMIT TË INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR

RREGULLORE

PËR
MBROJTJEN E SHËNDETIT NGA PRODUKTET E DUHANIT NË
DREJTORINË E SIGURIMIT TË INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR (DSIK)

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është mbrojtja e shëndetit publik nga përdorimi i produkteve të duhanit në ambientet e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK).

Neni 2
Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është marrja dhe zbatimi i masave parandaluese të pirjes së duhanit në mjediset e punës së Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK), në zbatim të neneve 15/a, 15/b të ligjit nr. 9636, datë 06.11.2006, i ndryshuar.

Neni 3
Përkufizime

1. “Mjedis pune” konsiderohet çdo hapësirë e mbyllur, ku punonjësit ushtrojnë veprimtarinë dhe detyrat për të cilat janë punësuar, si dhe salla mbledhjesh, korridore, shkallë, dhoma tualeti dhe çdo mjedis tjetër i mbyllur, që frekuentohet gjatë orarit të punës, ne DSIK.
2. “Pirje duhani” është ndezja, thithja dhe mbajtja në dorë e ndezur e cdo produkti duhani që digjet.
3. “Tavllë duhani” është një enë e vogël ku shkundet hiri i produktit të duhanit që po digjet dhe ku lihen bishtat e cigareve.
4. “Masat parandaluese të duhanpirjes” janë veprimtaritë sistematike, që synojnë të sigurojnë mbrojtjen e shëndetit të nepunesve/punonjesve të DSIK-se apo personave të tjerë që për arsye pune vijnë në institucion, duke zgjatur jetën dhe përmirësuar cilësinë e saj.

Neni 4
Masat parandaluese të duhanpirjes dhe personi përgjegjës.

1. Personi përgjegjës për marrjen e masave parandaluese të duhanpirjes në institucion përcaktohet me urdhër të Drejtorit të DSIK-së.
2. Personi përgjegjës mban përgjegjësi për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit në DSIK dhe vendosjen në një vend të dukshëm të shenjave, që tregojnë se pirja e duhanit në këto mjedise është e ndaluar, si dhe të heqë e të mos lejojë vendosjen e tavllave të duhanit në këto mjedise.

Neni 5

Gjobat administrative

Në bazë të nenit 20 të ligjit në fuqi, gjobat administrative për shkeljet e neneve 15/a, 15/b të ligjit dhe të kësaj rregulloreje, janë si më poshtë:

1. 300.000 lekë, subjekti i tatueshëm (DSIK)
2. 50.000 lekë, personi përgjegjës në institucion.
3. 5.000 lekë, duhanpirësi

Neni 6

Institucionet për kontrollin e zbatimit të kësaj rregulloreje dhe të ligjit në fuqi

Institucionet me funksion monitorimi dhe kontrolli janë Inspektoriati Sanitar Shtetëror, Policia Bashkiake ose Komunare, sipas territorit të juridiksionit të tyre, te cilet mund te hyjne ne institucion sipas rregullave te hyrje – dajles ne DSIK.

Neni 7

Ankimi

Ankimi ndaj vendimeve të trupave inspektues, të përcaktuara në këtë ligj, bëhet në përputhje me ligjin për inspektimin. Pas përfundimit të procedurave të ankimit administrativ, bëhet ankimi në Gjykatën Administrative, brenda afateve dhe sipas procedurave të parashikuara në dispozitat e ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.